

Dr. Musli Vërbani

Tregime për sehabet e Muhamedit a.s. dhe kundërshtarët e tij

(365 tregime për fëmijën tuaj brenda 12 muajve të vitit)

Kaçanik, 2020

Titulli:

Tregime për sehabet e Muhamedit a.s. dhe kundërshtarët e tij


Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektues:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori



Tregime për sehabet e Muhamedit a.s. dhe kundërshtarët e tij



Ishte një familje Islame.
Ajo familje ishte prej familjeve të para të cilat e kishin pranuar Islamin.
Baba në atë familje quhej Jasir.
Gruaja e Jasirit ishte Sumeja.
Djali i tij ishte Amari.
Amari është personi i parë në islam që ndërtoi xhami.

Prindërit dhe fëmijët e tyre ishin bashkuar
dhe i shërbenin çështjes islame.
Familja e Jasirit u sprovua e tëra për çështjen e fesë.
Ata duruan torturat çnjerëzore.
I pari dëshmor burrë në islam është Jasir ibnu Amir El-Kendij.

Në Kur'an Zoti i Lartmadhëruar thotë:
**“Kurrresi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut.
Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.”**

Muhamedi a.s. e kishte kryer Isranë dhe Miraxhin.

Ishte kthyer dhe u kishte treguar mekasve për këtë udhëtim.

Mekasit kur e dëgjuan, nuk e besuan.

Një grup i Mekasve shkuan te Ebu Bekri dhe i thanë:

- A mendon ti se shoku yt ka shkuar deri në mesxhidi Aksa, e pastaj është kthyer deri në Mekë gjatë një nate?

Ebu Bekri r.a. pyeti: - A e ka thënë ai këtë?!

Kurejshitët u përgjigjën: - Po.

Ebu Bekri u përgjigj: - Unë dëshmoj se nëse ai e ka thënë këtë, të vërtetën e ka thënë.

I thanë Ebu Bekrit: - Ti i beson se ka shkuar deri në mesxhidi Aksa gjatë një nate, e pastaj është kthyer deri në Mekë para se të gdhijë?!

Ebu Bekri u përgjigj: - Po, bile unë i kam besuar edhe më shumë se kaq.

I kam besuar kur ka filluar ta pranojë shpalljen nga qielli.

I kam besuar dhe unë besoj në gjërat që janë më të çuditshme se kjo, siç është Xheneti dhe Xhehenemi.

Për këtë Pejgamberi a.s. e titulloi atë **“Es-Siddik”**.

Es-Siddik do të thotë person i drejtë.

Es-Siddik do të thotë person i singertë, pa pasur asnjë dyshim në besim.

Virtytet e Ebu Bekri r.a.

Një ditë përderisa i Dërguari i Allahut po mbante një fjalim mes shokëve të tij, papritur ndali dhe pyeti:

- A ka ndonjë midis jush që agjëron sot?

Ebu Bekri u përgjigj me zë të ulët duke thënë se ai po agjëronte.

I Dërguari i Allahut pyeti përsëri:

- A ka ndonjë që ka dhënë sadaka?

Mbizotëroi heshtja e ndjekur nga zëri i turpshëm i Ebu Bekrit:

- Unë kam dhënë o i Dërguari i Allahut.

Pyetjet vazhduan:

- A ka ndonjë që ka falur një namaz xhenazeje sot?

Dukej sikur Pejgamberi po bisedonte me një person të vetëm.

Ebu Bekri përsëri u përgjigj:

- Unë kam falur.

Pejgamberi fisnik vazhdoi:

- A ka ushqyer ndonjë nga ju një njeri të uritur sot?

Asgjë nuk ndryshoi nga më parë.

I Dërguari i Allahut po u bënte të njohur xhematit se kush ishte Ebu Bekri.

Ai e dinte se po t'i lihej në dorë Ebu Bekrit ai kurrë nuk do t'i përmendte këto virtyte.

Pejgamberi a.s. ishte sëmurë.

Gjatë kësaj kohe në namaz e zëvendësonte Ebu Bekri.

Një ditë Pejgamberi e ndjeu veten më mirë.

Shkoi për të falur namazin e drekës.

Ai gjatë rrugës mbështetej tek Aliu dhe Abasi.

Fytyra e tij i rrezatoi me gëzim dhe kënaqësi kur e pa Ebu Bekrin duke prirë namazin.

Kur e pa prezencën e Pejgamberit, Ebu Bekri deshi të bënte një hap mbrapa.

Pejgamberi e ndaloi atë dhe u ul në krahun e tij.

Mbas namazit Pejgamberi dha fjalën e tij të fundit:

“Allahu i paraqiti njërit nga shërbëtorëve të Tij zgjedhjen e jetës në këtë botë dhe jetës me Të. Por shërbëtori zgjodhi të fundit.”

Ebu Bekri i dëgjoi këto fjalë atij i rrjedhën lotët nga sytë dhe u rrokullisën poshtë në mjekrën e tij.

Herët në mëngjes, në ditën e fundit të jetës së tij, gjendja e Pejgamberit u bë më e mirë për disa çaste.

Si e pranoi Umeri r.a. islamin

Një ditë pranë Qabes banorët e Mekës bisedonin se si ta zhdukin Muhamedin a.s. dhe shokët e tij.

Umeri çohet në këmbë e thotë:

- Sot unë do ta mbys Muhamedin dhe do të lirohem përgjithmonë prej fesë së tij.

E mori shpatën dhe u nis në drejtim të Muhamedit a.s.

Në mes të rugës e takon një shok.

- Ku po shkon o Umer? – e pyet shoku.

- Ta mbys Muhamedin – tha Umeri.

- Së pari rregulloje familjen tënde e pastaj tjerët – tha shoku.

- Çka do të thuash me këtë? – e pyeti Umeri.

- Motra jote Fatimja dhe burri i saj e kanë pranuar Islamin dhe tani lexojnë Kur'an – i tha shoku.

Umeri u hidhërua dhe shkoi me tërbim te shtëpia e motrës së tij.

Në atë moment ishin duke lexuar pjesë të Kur'anit fisnik.

Kur trokiti Umeri në derë, motra e tij e fshehu atë pjesë të Kur'anit të cilën e lexonte.

Kur hyri Umeri brenda, i ra shuplakë me të fortë burrit të motrës, Said-it.

Motra shkoi t'i ndihmojë burrit të saj.

Umeri e rrahu edhe motrën, derisa filloi t'i rrjedhë gjak për hunde e fytyrë.

Kur e pa Umeri gjakun në fytyrën e motrës së tij, iu dhimbs dhe u zbut.

Pastaj Umeri i tha: - Ku është pjesa e Kur'anit të cilin e lexonit më parë?

Motra i tha: - Atë pjesë të Kur'anit e kam unë, por ti je i papastër dhe nuk mund ta prekësh deri sa të pastrohesh.

Umeri u pastrua, e mori atë pjesë të Kur'anit dhe e lexoi dhe drita e Kur'anit hyri në zemrën e tij, drita e Islamit e mbuloi trupin e tij dhe tha:

- A prej kësaj po ikin kurejshët?

Pastaj u tha: - Ku është Muhamedi?

- Në shtëpinë e Ekreme Bin Ubej bin Erkem- iu përgjigjën.

Umeri shkoi atje, trokiti në derë dhe pastaj ia hapën derën, shkoi para Muhamedit a.s. dhe tha:

- **Esh-hedu en Laa ilaaha il-laLlaah ve esh-hedu enne Muhamedun resuulull-Llaah.**

Në gjuhën shqipe d.m.th.:

Dëshmoj dhe deklaroj se vetëm Allahu është Zot.

Dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është i dërguar i Allahut.

Umeri dhe vajza e cila shiste qumësht

Umeri ishte halife.

Një natë, Umeri së bashku me shërbëtorin e tij, Eslemin, del për një inspektim në qytet për të parë nevojat e qytetarëve.

Pas një udhëtimi ndalojnë që të pushojnë në një kënd të qytetit.

Aty dëgjon një zë të një gruaje të moshuar duke e urdhëruar bijën e saj që ta përziehte qumështin me ujë.

Mirëpo, vajza refuzonte që ta përziehte qumështin me ujë, duke i thënë: - Oj nënë, ti e di se Umeri e ka ndaluar që të përziehet qumështi me ujë dhe të shitet, sepse kështu tradhtohen njerëzit.

Nëna i thotë: - Po edhe nëse është ashtu, ku është Umeri tani, ai nuk na sheh.

Vajza besnike i thotë: - Pse a duhet ta dëgjojmë halifen e muslimanëve – Umerin - para njerëzve, ndërsa në të fshehtë jo?!

Kjo thënie e gëzoi Umerin r.a. dhe e mahniti besimi i saj dhe besnikëria e saj.

Të nesërmen në mëngjes pyeti për atë vajzë dhe u njoftua se ishte Umi Amaretu bin Sufjan bin Abdullah Eth-Thekafij.

Kur e kuptoi se ajo vajzë ishte e pamartuar, atëherë kërkoi që ajo të martohej me djalin e tij Asimin.

Pasi u martuan, Zoti e bekoi këtë martesë dhe pas tyre trashëguan halifen e drejtë, Umer bin Abdul Azizin.

Drejtësia e Umerit

Në Egjipt guvernator ka qenë Amër bin Asi.

Në atë kohë mbaheshin garat në vrapim.

Në garë merr pjesë edhe djali i guvernatorit.

Vrapimi filloi dhe secili dëshironte të fitonte garën.

Para arritjes në cak, ndër të parët ishte djali i Amër bin Asit, mirëpo një Egjiptas ishte më i shpejtë dhe e zë vendin e parë, ndërsa djali i Amrit e humbi garën.

Pas përfundimit të garës, kur Egjiptasi e merr shpërblimin,

djali i Amër bin Asit e merr një kamxhik dhe i bie Egjiptasit dhe i thotë:

- Si guxove të ma kalosh, përderisa unë kam marrë pjesë në garë dhe jam djallë i fisnikëve.

Publiku e vërejti këtë veprim andaj i thonë Egjiptasit që të ankohet te guvernatori, mirëpo ai nuk tentoi që të paraqesë ankesë, pasi që dyshonte se babai do t'ia mbante anën të birit.

Disa të tjerë i thonë që të ankohet te halifeja i drejtë i muslimanëve, Umer bin Hatabi, i cili nuk ja shkel të drejtën askujt dhe u ndihmon të dobëtëve ndaj të fortëve.

Egjiptasi shkon në Medine dhe me lehtësi arrin te halifja dhe i thotë:

- O Emir i besimtarëve, unë jam Egjiptas dhe kam fituar në vrapim, mirëpo prej dëshpërimit se nuk ka fituar, djali i Amrit më ka rënë me kamxhik duke më thënë se si guxove të ma kalosh kur unë jam djali i fisnikëve.

Umeri r.a. dërgoi një letër te Amër bin Asi, në të cilën shkruante:

- Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit. Nga robi i Zotit, emiri i besimtarëve deri te Amër bin Asi. Kur të arrijë kjo letër deri tek ju, eja ti së bashku me djalin.

Kur Amri e pranoi letrën, shkoi në Medine dhe i thotë Umerit se për çfarë është fjala.

Umeri e kuptoi se babai nuk dinte asgjë dhe e kuptoi se ankesa e Egjiptasit ishte e drejtë.

Pasi e vërtetoi me dëshmitarët,

ia jep kamxhikun Egjiptasit dhe i thotë: **- Bjeri djalit të fisnikëve.**

Egjiptasi i bie dhe e merr të drejtën e tij.

Umeri r.a. meriton respekt

Umeri r.a. ishte udhëheqës i muslimanëve.

Arritën stofat Jemenase.

Iu shpërndanë muslimanëve, të gjithëve në mënyrë të barabartë dhe me drejtësi.

Umeri veshi rrobat e reja të cilat vëreheshin se ishin një numër më i madh.

Këtë e vërejtën muslimanët, pasi që gjërat shpërndareshin haptazi.

Umeri hipi në minber dhe filloi të mbajë fjalim.

Në fjalimin e tij thoshte: - **Dëgjomëni dhe respektoni.**

Dëgjohej zëri lart:

- **Nuk ka dëgjueshmëri dhe nuk ka respekt,
mos dëgjoni dhe mos respektoni.**

Kështu brohoritën dhjetëra ushtarë duke shprehur pakënaqësi.

Umeri me butësi thotë:

- Po pse kështu? Allahu ju mëshiroftë!.

Njëri thotë:

- Ju keni marrë stof sa kemi marr dhe ne, mirëpo si është e mundur që ajo të të mjaftojë ty për këmishë, kur ti je më i gjatë se ne? Diçka nuk është në rregull! Patjetër se ti ke marrë një hise më shumë se ne.

Umeri e arsyeton veten duke e thirrë djalin e tij, Abdullahun, për ta argumentuar.

Djali i tij, Abdullahu, deklaroi me zë të lartë se hisen e tij ia kishte dhënë babës, prandaj që të dy hiset i kanë mjaftuar për një këmishë, sepse vetëm njëra (pjesa e tij) nuk i mjaftonte as për t'i mbuluar organet e turpshme.

Të gjithë e pranuan dhe revoltuesi qetë tha:

- **Tani meriton dëgjim dhe respekt.**

Umeri r.a. dhe familja e jetimit

Një natë Umeri r.a. kishte dalë për të kontrolluar qytetin.
Arrin në një tendë, e cila ishte tri milje larg Medinës.
Vëren se në atë tendë ishte i ndezur një zjarr.
I afrohet tendës.
Sheh se brenda ishte një grua me fëmijët e saj, të cilët qanin.

Umeri e pyet gruan:

- Si po kaloni?

Ajo i përgjigjet:

- Është natë e ftohtë.

- Po fëmijët pse po qajnë?

- Për shkak se janë të uritur.

- Po çka ka në kusi?

- Ujë. E përziej që fëmijët të mendojnë se është ushqim, deri sa fëmijët të flenë.

Pastaj gruaja thotë:

- Allahu është në mes nesh dhe Umerit.

Umeri i thotë:

- Zoti të mëshiroftë, po ku e di Umeri gjendjen e juaj?

Gruaja i përgjigjet:

- Ai e ka marrë përsipër qeverisjen për ne, ndërsa nuk di asgjë për ne?!

Umeri me të shpejtë shkon në depon shtetërore. Merr gjëra ushqimore: miell, vaj, dhe i vendos në shpinën e tij për t'ia sjellë në tendë,
Nuk e lejon që dikush tjetër t'i bartë pas tij, duke thënë se në Ditën e Kijametit askush nuk do të mund t'i bart mëkatet e tij.

Pastaj Umeri, Emiri e besimtarëve, përgatiti ushqimin për fëmijët, ndërsa gruaja habitet me atë përgatitje dhe thotë:

- Zoti të shpërbleftë me të mira. Për Zotin, ti ke më shumë të drejtë të jesh Emir i besimtarëve se sa Umeri.

Uthmani r.a. dhe vakëfi

Pas Hixhretit,
 u rrit numri i muslimanëve.
 Nevojitej zgjidhje për problemin e ujit.
 Njëri prej puseve më të mëdha të Medinës ishte pusi Ruma.
 Ky pus i ujit ishte në pronësi të një njeriu.
 Ai njeri ishte koprrac dhe pa të holla nuk lejonte asnjë pikë ujë.
 Uthmani r.a. e kuptoi këtë.
 Shkoi te ai dhe i ofroi që t'ia blejë gjysmën e pusit.
 Një ditë ai do ta shfrytëzonte pusin,
 ditën tjetër ta shfrytëzonte Uthmani r.a.
 Ai llogariti që Uthmani r.a. është tregtar i aftë dhe ai do ta rrit çmimin e ujit, kështu që ai do të kishte dobi të dyfishtë andaj e pranoi këtë marrëveshje.
 Ndodhi e kundërta.
 Shitja e ujit dita ditës filloi të bie, derisa më askush nuk kërkoi ujë nga njeriu tjetër.
 Kjo e çuditi dhe duke kërkuar shkakun,
 kuptoi që Uthmani r.a. ua jepte ujin pa të holla çdokujt që i nevojitej.
 Pas një kohe, ai ofroi shitjen e gjysmës tjetër të pusit dhe Uthmani e bleu të tërën.
 Një sahab shkoi te Uthmani r.a. dhe i ofroi një shumë të madhe të hollave për ta blerë pusin.
 Uthmani r.a. e refuzoi duke i thënë: – Më ofrojnë më shumë.
 Ky me këmbëngulësi e rriste çmimin, derisa në fund i tha: – Unë e di që nuk ka blerës që të ofrojë më shumë se unë.
 Uthmani r.a. u përgjigj: **Allahu i Madhërishëm!**
 Uthmani r.a. pusin e bëri vakëf për muslimanët.

Uthmani dhe sadakaja

Në kohën e halifatit të Umerit r.a.,
ndodhi një thatësi e madhe në Medine.
Muslimanët me ditë të tëra nuk kishin ushqim.
Njerëzit iu ankuan halifes, ndërsa ai tha:
- Shpresoj që Allahu deri në fund të ditës do të na dhurojë një zgjidhje.

Para akshamit atë ditë erdhi një karvan i pasur tregtar.
Karvan i pasur tregtar që i takonte Uthman Ibn Affanit.

Uthmani e vendosi ushqimin në magazina.
E shiste mallin me shumicë.
Shkojnë tregtarët e Medinës dhe i thanë:
- Do të japim dy monedha për atë që ti e ke paguar me një!
Uthmani u tha: - Jo, dua më shumë!

- Do të japim 3, 4 - i thoshin tregtarët.
Uthmani kërkonte më shumë.

- Do të japim 5, 6 - i thoshin tregtarët.
Uthmani kërkonte më shumë.

Në fund, tregtarët i thanë se nuk mund të japin më shumë se 7 dinarë.
Uthmani u tha se mallin do t'ia jap atij që ofron më shumë.
Po kush mund të të jap më shumë se ne kur ne jemi njerëzit më të pasur në Medine? – i thanë ata.

Uthmani tha: - Allahu! Ai jep dhjetë herë më shumë apo edhe 700 herë më shumë!
Ju kam dëshmitar se unë këtë mall ua dhurojë të uriturve të Medines!

Pronari i dy dritave

Uthmani r.a. i përkiste një familjeje fisnike Kurejshe në Mekë.

Ai e pranoi Islamin në ditët e para.

Uthmani r.a. ishte njeri modest dhe i devotshëm.

Ai në jetën e tij ka qenë e thjeshtë.

Uthmani r.a. mësoi shkrim-lexim në një moshë shumë të re.

Njëra nga vajzat e Pejgamberit a.s., Rukija r.a., martohet me Uthmanin r.a..

Muhamedi a.s. për Uthmanin tha:

- Uthmani është njeriu i parë i Umetit tim i cili emigroi për hir të Allahut me familjen e tij.

Për hir të Islamit Uthmani r.a. emigroj dy herë:

- një herë në Abisini;

- një herë në Medine.

Në betejën e Bedrit, Muhamedi a.s. e liroi atë nga pjesëmarrja në betejë për shkak të sëmundjes së Rukijës.

Sëmundja e Rukijës u dëshmuar të jetë fatale, duke e lënë Uthmanin të vrerosur.

Pas vdekjes së Rukijës r.a., Pejgamberi a.s. e martoi me vajzën tjetër të tij, Ummu Kulthumën r.a.

Uthmani e ka titullin “**dhun-nurejn**” për shkak se është martuar me dy vajzat e Muhamedit a.s.

Dhun-Nurejn do të thotë “**pronari i dy dritave**”.

Ishte një djalosh, emri tij ishte Ali.
I kishte mbushur 9 vite.
Një ditë hyri në dhomën e Pejgamberit a.s.
Pejgamberi a.s. bashkë me Hatixhen r.a. ishin duke falur namaz.
I pa Pejgamberin a.s. dhe gruan e tij që kishin rënë me ballë për tokë, u habit.
Kur përfunduan namazin,
Aliu e pyeti Pejgamberin a.s. se çka ishin ato veprime të reja.
Pejgamberi a.s. iu përgjigj duke i thënë:
**“I lutemi Allahut, të vetmit Zot,
të kisha këshilluar që edhe ti të veprosh kështu.
Të mos adhurosh Latin dhe Uzanë dhe asnjë idhull tjetër.”**
Aliu i habitur tha:
- Një gjë të tillë se kam dëgjuar kurrë më parë.
Së pari do të konsultohem me babin tim, pastaj të jap përgjigje për këtë.

Pas pak djaloshi u kthye tek Pejgamberi a.s..
Pejgamberi a.s. e pyeti: - A ishe tek babai yt?
Ai u përgjigj:
- **Allahu nuk e ka pyetur babin tim kur e ka krijuar,
pse ta pyes unë babin tim që ta adhuroj Allahun?**

Gatishmëria për sakrificë

Idhujtarët bënë një mbledhje.
Me propozimin e Ebu Xhehlit, vendosin ta vrasin Pejgamberin.
E rrethuan shtëpinë e tij.
Por Allahu e njoftoi pejgamberin a.s.
Pejgamberi e urdhëron Aliun që të flejë në shtratin e tij.
I tha që ta mbulojë kokën me një rrobë të tij dhe i tha se nuk do t'i ndodhte asgjë e keqe.

Pejgamberi hapi derën dhe
doli nga shtëpia duke kaluar përmes shpatave të tyre pa e vërejtur ata fare.

Ai mori dhé nga toka e ua vendosi mbi kokat e tyre njëri pas tjetrit, dhe njëkohësisht
lexonte suren Jasinë.
Kështu kaloi e shkoi nën mbrojtjen e Allahut.

Aliu fjeti në shtratin e Pejgamberit me kokë të mbuluar,
ata e thyen derën,
e gjetën Aliun në shtrat, të mbështjellë me një pelerinë të gjelbër.
Ata mendonin se ishte Muhamedi dhe filluan të mburreshin e të krenoheshin.
Pritën sa të çohet, që t'i vërsuleshin e ta vrisnin.
Aliu r.a. mbeti në krevatin e Pejgamberit a.s.

Pasi kishin pritur gjithë natën rreth shtëpisë së Pejgamberit,
idhujtarët ishin habitur kur kishin parë Aliun të dilte që atje!
I gatshëm dhe patrembur duke pritur idhujtarët të cilët erdhën me shpata,
Aliu r.a. i priti pa kurrfarë frike.
Ai ishte hero i vërtetë, i cili me heroizmin e tij e obligoi tërë ummetin.

Aliu r.a. shkoi në Xhami.
Para xhamisë duhej ta linte devenë.
E takoi një djalosh.
I tha një djaloshi që t'ia ruajë devenë derisa ta fal namazin.

Derisa ishte duke u falur, djaloshi ia hoqi kërpeshin nga deveja dhe iku.
Aliu r.a. doli nga xhamia.
E pa devenë pa kërpesh dhe pa se djaloshi kishte ikur.

E thirri një djalë tjetër.
Ia dha 20 dërhëm për t'ia blerë një kërpesh tjetër në treg.
Djaloshi, në treg hasi në atë që e kishte vjedhur kërpeshin, por nuk e njihte andaj e bleu kërpeshin për 20 dërhëm.
Ia solli Aliut r.a.
Aliu r.a. tha:
- Unë gjithsesi atij desha t'ia jap 20 dërhëm për ruajtjen e devesë.
Mirëpo, ai nuk duroi dhe ajo që ka qenë e përcaktuar ta fitojë e mori, por në mënyrë haram.
Nafaka vjen nga një apo tjetër anë, por më mirë të vjen hallall.

Në kohërat e vjetra ka ekzistuar skllavëria.
Bilal Ibn Rebbahu r.a. ishte njëri prej skllavëve.
Bilali ishte rob i Umejes.
E pranoi Islamin duke qenë rob i Umejes.
Umeje e urdhëroi Bilalin që të kthehet në idhujtari.
Bilali nuk pranoi.
Umeje e merr Bilalin dhe e lidhë për këmbë e për duar dhe e qet në mes të shkretëtirës.
Dielli ishte i fortë.
Era e nxehtë, qielli përcëllues.
Nuk i jepte as ujë të pijë që të freskohet.
Mbi trupin e tij vendosi gurë të mëdhenj të nxehtë.
E rrihte me kamxhik.
Të gjitha këto torturime nuk ndikuan aspak që Bilali të largohet prej fesë Islame.
Ai vazhdimisht thoshte: **“Huvallahu Ehad”**
Që në gjuhën shqipe d.m.th. **“Allahu është një i Vetmi”**.
Në këtë gjendje të vështirë shkon Ebu Bekri Sidiki dhe e blen Bilalin prej Umejes dhe e liron.
Bilali më vonë bëhet **Muezini i parë në Islam**.
Zëri i tij i bukur ishte faktor tjetër i popullaritetit të Bilalit.

Pejgamberët nuk pranojnë Sadaka

Selmani ishte Persian, besonte zjarrin.

Shkon në Siri te kryepeshkopi i kishës.

- Unë e dua këtë fe dhe dëshiroj të qëndroj me ju në kishën tuaj.

Pas një kohe kryepeshkopi bie në shtrat të vdekjes.

Ai i thotë: - O biri im, ka ardhur koha të vijë një pejgamber prej fesë së pastër të Ibrahimit,

do të vijë në vendet arabe, ai do të emigrojë në një vend ku do të ketë hurma (Medinë).

Ai do të ketë argumente të qarta, **nuk e pranon Sadakanë, por e pranon dhuratën.**

Selmani hipë në një kafshë dhe pyet për gadishullin arabik se ku gjendet.

E zënë rob dhe e shitën si rob te një Jehudi.

Një Jehudi tjetër prej fisit Beni Kurejdha e blen Selmanin nga pronari i tij dhe e dërgon e në Medine ku ai banonte.

Pejgamberi a.s. shpallet pejgamber në Meke, e pastaj emigron në Medinë.

Një ditë, deri sa Selmani qëndronte në maje të hurmës,

ndërsa nën hurme pronari i tij ishte ulur, vjen djali i axhës së zotërisë dhe i thotë:

- Evisi dha Hazrexhi janë mbledhur në Kuba për të pritur njeriun, i cili sot do të vijë prej Mekes dhe thonë se ai është Pejgamber.

Kur bëhet natë, Selmani merr ushqim me vete dhe shkon në Kuba te i Dërguari i Allahut.

Hyn aty ku qëndronte Pejgamberi me shokët e vet e vendos para tyre dhe u thotë:

- Ju jeni udhëtarë dhe nevojtarë, kisha ushqim dhe vendosa të jap sadaka dhe ju keni prioritet më shumë se të tjerët.

I Dërguari i Allahut u thotë sehavebe:

- Hani dhe filloni me Bismilah, por vet i Dërguari i Allahut nuk hëngri.

Të nesërmen në mesditë Selmani shkoi prapë te i Dërguari i Allahut.

Me vete kishte marrë ushqim dhe i thotë Pejgamberit a.s.:

- E kam parë se ti dje nuk ke ngrënë, se ka qenë sadaka. Kjo tani është dhuratë që e kam sjellë posaçërisht për ty.

Pejgamberi a.s. u thotë Sahabëve: - **Hani me Bismilah** dhe hëngri së bashku me ta.

Selmani mendoi:

- **Ky është argument se është pejgamber.**

Vula e pejgamberisë së Muhamedit a.s.

Selmani ishte Persian, besonte zjarrin.

Shkon në Siri te kryepeshkopi i kishës.

- Unë e dua këtë fe dhe dëshiroj të qëndroj me ju në kishën tuaj.

Pas një kohe kryepeshkopi bie në shtrat të vdekjes.

Ai i thotë: - O biri im, ka ardhur koha të vijë një pejgamber prej fesë së pastër të Ibrahimit.

Do të vijë në vendet arabe.

Ai do të emigrojë në një vend ku do të ketë hurma.

Ai do të ketë **në krah vulën e pejgamberllëkut.**

Selmani e dinte se hurma ka në Medine.

Shkon në Medine, por atje e zunë rob dhe e shitën tek një jehudi.

Një ditë prej ditëve Selmani dëgjon për një pejgamber që kishte ardhur në Medine.

Ky ishte shansi që priste Selmani.

Një ditë në varrezën Bekie Pejgamberi a.s. përcillte një kufomë dhe përreth i kishte sahabët.

Selmani shkon, i përshëndet.

Pas pak i sillet rreth e rrotull Pejgamberit a.s. për të parë vulën, të cilën ia kishte përshkruar kryepeshkopi.

I Dërguari i Allahut a.s. e kupton se çka hulumtonte Selmani, atëherë e heq këmishën prej kraharorit dhe Selmani e sheh vulën, ashtu siç i ishte përshkruar.

I afrohet e ia puth vulën duke qarë dhe e pranon islamin.

Një ditë i Dërguari i Allahut a.s. i thotë Selmanit: - Thuaj pronarit që, nëse dëshiron të të shes, ne do të të blejmë dhe do të të lirojmë nga robëria.

Selmani i thotë pronarit dhe ai pranon.

I Dërguari i Allahut a.s. u kërkon sahabëve që t'i ndihmojnë Selmanit që ta blejnë dhe ta lirojnë, kështu ai bëhet njeri i lirë.

I Dërguari i Allahut a.s. për të ka thënë: - **Selmani është i yni.**

Suhejbi ishte një djalë i mirë, bujar dhe fisnik.
 Një ditë ushtria bizantine shkon dhe e zë rob në shtëpinë e tij.
 Pasi që e zë rob, ai rritet si skllav, por pasi që rritet ikë dhe shkon në Mekë.

Në Mekë filloi të merrej me tregti.
 Duke u marrë me tregti pasurohet shumë.
 Një ditë, derisa kthehej nga tregtia, dëgjon se Muhamedi, i biri i Abdullahut, është dërguar Pejgamber dhe ka filluar t'i thërras njerëzit në besimin e të vetmit Zot.

Prej të parëve që e kanë pranuar Islamin është edhe Suhejbi.
 Për shkak të Islamit është maltretuar shumë.
 Muslimanët migrojnë në Medinë, e edhe Suhejbi vendos të migrojë.

Kur e merr rrugën e migrimit, i shkojnë pas mekasit dhe e arrijnë atë në periferi të Mekës.

Ai përgatit shigjetën dhe u thotë:

- Asnjë nuk mund të më afrohet derisa të më harxhohen të gjitha shigjetat, e pastaj e kam shpatën dhe nuk do të dorëzohem derisa të më punojë dora.

Njëri prej mekasve i thotë:

- Ti ke ardhur në Mekë pa pasuri, ndërsa sot je prej më të pasurve.

Suhejbi i thotë:

- Po sikur t'ju lë tërë pasurinë time, a do të ma lironit rrugën?

- Po - i përgjigjen.

Suhejbit nuk iu dhimbs pasuria, u tregoi atyre ku e kishte pasurinë dhe ata shkuan, e morën pasurinë e tij dhe e lirojnë.

Kishte mallëngjim që sa më shpejtë të takohej me të Dërguarin e Allahut.

Ecte me të shpejtë, lodhej e nuk pushonte derisa e pa të Dërguarin e Allahut.

Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i thotë Suhejbit:

- O Ebu Jahja, triumfoi pasuria jote.

Fytyra e Suhejbit shkëlqeu dhe ai tha:

- Për Allahun ty nuk të ka treguar askush pos Xhibrilit.

Xhibrili e kishte zbritur ajetin kur'anor, shkak i të cilit ishte rasti i Suhejbit:

“Ka njerëz që flijojnë veten për të fituar kënaqësinë e Allahut,

Allahu është shumë mirënjohës ndaj robërve të Vet.”

Vereka ibnu Neufel

Pejgamberit a.s. iu shfaq për herë të parë Xhibrili a.s. në shpellën Hira.

Ai u kthye i frikësuar në shtëpi.

Me të hyrë në shtëpi, ai u tha familjarëve:

- Më mbuloni! Më mbuloni!

Gruaja e tij Hadixheja e mbuloi.

Në mëngjes, Hadixheja vajti me Pejgamberin a.s. tek Vereka ibnu Neufel.

Ai kishte njohuri mbi fetë qiellore dhe vetë ishte në fenë e Ibrahimit a.s.

I dërguari i Zotit në prezencën e Hadixhes i rrëfeu gjithçka që i kishte ngjarë atë natë.

Pasi e dëgjoi, Vereka ibnu Neufel i tha:

- Për Zotin, i cili ka në dorë jetën time,

ti je Pejgamberi i këtij umeti dhe je pejgamberi i fundit.

Ty të ka ardhur shpallja që i ka ardhur Musait.

Populli yt do të të përgënjeshtrojnë.

Populli yt do të të lëndojnë, luftojnë.

Populli yt do të të nxjerrin nga qyteti.

Pejgamberi a.s. e ndërpret dhe i thotë:

- Do më përzërë populli im?!

Vereka bin Nufel i tha:

- Po.

Nuk i është shpallur kujt ajo që të është shpallur ty e që të mos ketë pasur armiq.

Ah sikur të isha i ri të të ndihmoja kur të vijë ajo ditë.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

- Kurrë mos e shani Vereka ibnu Neufel, pasi unë e kam parë atë në xhenet.

I dërguari i Zotit fliste mbi vlerën e sadakasë.
Ebu Dahdah e dëgjonte.
Ai kishte një fermë.
Ferma e tij ishte prej fermave më të mira në Medinë.

Fjalët e Pejgamberit a.s. ndikuan shumë tek Ebu Dahdah.
Shkoi te plantacioni i tij me hurma.
E dhuroi atë për çështjen islame.
E dhuroi të gjithë këtë fermë në shërbim të fesë së Zotit dhe lexoi ajetin Kur'anor:
**“Kush do t'i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t'ia kthejë shpërblimin shumëfish?
Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni.”**

Pejgamberit a.s. i shkoi lajmi që Ebu Dahdah kishte dhuruar fermën e tij më të mirë.
Pejgamberi a.s. tha:
- Sa shumë palma do të gjejë Ebu Dahdah në xhenet!

Ebu Hurejre do të thotë: **babai i maces së vogël.**

Këtë emër ai e mori për shkak se e mbante dhe luante me një mace.

Ai e pranoi islamin.

Nuk kishte tokë për të punuar.

Nuk merrej me tregti.

Vendi ku banonte ishte xhamia.

Mësuesi i tij ishte vetë Pejgamberi a.s.

Edukuesi i tij ishte vetë Pejgamberi a.s.

Ebu Hurejre iu përkushtua shërbimit të Pejgamberit a.s. dhe shoqërimit me të.

Për shkak se iu përkushtua nxënies së dijes, Ebu Hurejre vuajti nga kushtet e vështira të jetës.

Talenti i tij i vetëm ishte kujtesa dhe memoria e fortë.

Me të dëgjuar diçka, ai e mësonte menjëherë.

Mori përsipër përgjegjësinë e memorizimit të haditheve Pejgamberike me qëllim që t'ua përcjellë brezave të ardhshëm.

Hadithet e tij i kanë transmetuar mbi 800 burra nga shokët e Pejgamberit a.s. dhe brezi i tabi'inëve.

Abdurrahman bin Aufi r.a.

Muhamedi a.s. ishte me shokët e tij.
Në atë mes shkon edhe Abdurrahmani bin Aufi.

Pejgamberi a.s. e pyeti:
- Ku ishe o Abdurrahman?
Ai i tha: - O i dërguar i Zotit, isha duke numëruar paratë.

Pejgamberi a.s. i tha:
- **O Abdurrahman! Ti do të jesh nga banorët e xhenetit,**
por në xhenet do të hysh këmbadorazi.

Më pas, Pejgamberi a.s. i tregoi se si mund të hynte në xhenet duke ecur në këmbë.
Ai i tha: - **Duke i dhënë Allahut hua të bukur.**

Abdurrahmani filloi të japë pasuri duke ndihmuar të varfrit, me qëllim që të hyjë në këmbë në xhenet.
Një ditë, në Medine arriti një karvan prej shtatëqind devesh.
Shtatëqind devesh të ngarkuara me mallra të ndryshme dhe ushqime.
Karvani hyri në Medine, të gjithë banorët dolën jashtë për të parë.

Mes njerëzve ishte dhe Aisheja, gruaja e Pejgamberit a.s.
Aishja shkoi tek Abdurrahmani, pronari i këtij karvani, dhe i kujtoi hadithin e Pejgamberit a.s.: - **Duke i dhënë Allahut hua të bukur.**

Me të dëgjuar fjalët e Aishes, Abdurrahmani i thotë:
- **Oj Aishe! Ji dëshmitare që ky karvan me gjithë mallin, është dhuratë për t'u shpenzuar në rrugë të Zotit.**

Vëllazërimi i Sead bin Rebiut dhe Abdurrahman bin Aufit r.a. vetëm për Allahun

Abdurrahman bin Afi ka migruar prej Mekës në Medinë.
Sead bin Rebiu r.a. ishte prej ensarëve të Medinës.
Abdurrahman bin Afi nga një vend.
Sead bin Rebiu nga një vend tjetër.
Nuk kishin afërsi familjare.
Nuk ishin as partnerë afarist.
I vëllazëroi vetëm feja islame madhështore.

Vëllazërimi vetëm për Allahun e Lartmadhëruar ka qenë prej çështjeve më madhështore.

Sead bin Rebiu e ndan shtëpinë përgjysmë.
Gjysmën e ndalë për veten e tij,
gjysmën ia jep Abdurrahman bin Afi.

Ky ishte vëllazërimi ndërmjet sahabëve.
Kjo ishte dashuria ndërmjet sahabëve.
Kjo ishte përkrahja ndërmjet sahabëve.
Kjo ishte përkujdesja ndërmjet sahabëve.

Shtëpia e Ebu Ejubit r.a.

Muhamedi a.s. kishte shkuar nga Meka në Medine.
Në Medine vendosi të banojë te Ebu Ejubi.
Ebu Ejubi r.a. kishte një shtëpi dykatëshe.

Pejgamberi a.s. parapëlqeu katin e poshtëm.
Ai donte të qëndronte në katin përdhe.

Ebu Ejubi dhe bashkëshortja e tij mbetën pa gjumë tërë natën nga shqetësimi se i Dërguari i Allahut a.s. po flinte poshtë tyre.
Pandehnin se kjo ishte mungesë respekti ndaj Pejgamberit a.s.

Shqetësimin e tyre ua shtoi edhe një gjë tjetër, u rrëzua një enë që ishte mbushur me ujë.
Ebu Ejubi nxitimthi e mbuloi vendin me mbulesën e tij që ta thithte ujin, me qëllim që të mos pikonte në katin e poshtëm.

Të nesërmen në mëngjes ata ia treguan shqetësimin e tyre Pejgamberit a.s.,
atëherë ai pranoi të qëndronte në katin e dytë.

Familja e Ebu Ejubit r.a. përgatiste ushqim çdo ditë dhe ia çonte Pejgamberit a.s.
Nga pjesa që mbetej prej ushqimit të tij, hanin të gjithë pjesëtarët e familjes.

Pas pak ditësh edhe ensarë të tjerë kërkuan pjesën e tyre të mikpritjes.
Muslimanët e Medinës me radhë çonin ushqim në shtëpinë e Ebu Ejubit r.a.

Sad ibnu Ebi Vekkasi

Pejgamberi a.s. shkon në shtëpinë e Sadit.

Sadi i thotë:

- O i dërguari i Zotit!

Unë dua ta lë në testament që e gjithë pasuria ime të jepet në rrugë të Zotit.

Pejgamberi a.s i thotë: - Jo o Sad.

Sadi i thotë:

- Atëherë do të porosis që të jepen $\frac{2}{3}$ e pasurisë.

Pejgamberi a.s i thotë: - Jo.

- Atëherë do të porosis që gjysma e pasurisë të jepet në udhë të Zotit - tha Sadi.

Pejgamberi a.s. e kundërshtoi përsëri.

Sadi i tha: - Atëherë do të porosis që të jepet vetëm $\frac{1}{3}$ e pasurisë.

Pejgamberi a.s i thotë:

- **Bën, por edhe një e treta dhe është shumë o Sad. Është më mirë që pasardhësit e tu t'i lësh të pasur, sesa t'i lësh të varfër duke lypur nga njerëzit.**

Pas këtyre fjalëve, Pejgamberi a.s e luti Zotin që Sad ibnu Ebi Vekkasit t'i japë pasardhës të mirë dhe të ndershëm.

Ebu Talha dhe gruaja e tij Umi Selijm

Ebu Talha r.a. e kishte një fëmijë shumë të sëmurë.

Ai del nga shtëpia për punë,
djali i tij vdes.

Kur u kthye në shtëpi,
i thotë gruas së tij Umi Selijm:

- Si është puna me fëmijën?

Ajo i thotë:

- Ka pushuar dhe është qetësuar (duke pasur për qëllim se ka vdekur).

Ebu Tahla ka menduar se është shëruar.

Pas jacisë i afrohet gruas dhe flenë me të.

Më vonë gruaja e tij i thotë:

- O Ebu Tahla, çka mendon, nëse marrin borxh në një shtëpi, e pas një kohe familja e asaj shtëpie e kërkon borxhin, a është e drejtë t'ia ndalosh?

Thotë: - Jo.

Ajo i thotë:

- Kështu konsiderojë fëmijën tënd, pasi që fëmija yt ka vdekur e kërko shpërblim prej Zotit.

Ai hidhërohet me gruan e tij dhe i thotë:

- Më ke lënë që të bëhem i papastër prej marrëdhënieve, e tani po më tregon për fëmijën?!

Pastaj del prej shtëpie, shkon te i Dërguari i Allahut a.s. dhe i tregon çka i ka ndodhur. Muhamedi a.s. i thotë se gruaja jote ka vepruar me të drejtë dhe është lutur: - **Zoti ua bekoftë natën!**

Atyre u lindi një fëmijë.

Muhamedi a.s. e emëron Abdullah.

Pastaj Abdullahu i ka pasur nëntë fëmijë dhe të gjithë lexonin Kur'an.

Ky ka qenë pranimi i duasë së të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: **“O Zot bekoji ata!”**

Ebu Xhehli ishte një prej armiqve të Islamit.

Një ditë ai iu drejtua popullit të vet dhe u tha:

- Me të vërtetë Muhamedi është duke i ofenduar dhe turpëruar zotat tanë, dhe po thërret që ta braktisim adhurimin e tyre e të adhurojmë vetëm një Zot. Betohem se nesër do ta pres me një gur të madh, e kur ai të vijë për t'u falur, e të bjerë në sexhde, do t'ia hedh gurin mbi kokën e tij, e le të bëhet ç'të bëhet. Pas kësaj mendoj se ju do të jeni të qetë.

Në mëngjes, Ai e mori një gur dhe po e priste të Dërgurin e Zotit që të vinte për t'u falur.

Kurejshët e tubuar, me vëmendje prisnin se çdo të bënte Ebu Xhehli.

Muhamedi a.s. ishte i informuar rreth planit të Ebu Xhehlit.

Muhamedi alejhi selam ra në sexhde.

Ebu Xhehli mori gurin e rëndë dhe u nis drejt tij, me qëllim që t'ia hidhte mbi kokë, por sapo iu afrua të Dërguarit alejhi selam filloi të zmbrapsej, kurse fytyra e tij ishte zverdhur dhe dukej qartazi një frikë e madhe. Ai e hodhi gurin larg dhe filloi të ikë.

Kurejshët mbetën të habitur nga ajo që ndodhi me Ebu Xhehlin. Përse u tërhoq dhe nuk e hodhi gurin mbi kokën e Muhamedit alejhi selam kur qe shumë pranë tij?!

Njëri nga kurejshët u ngrit dhe e pyeti:

- Ç'të ndodhi?! Përse u tërhoq dhe nuk e hodhe gurin mbi kokën e Muhamedit?!

Ebu Xhehli tha:

- Unë isha duke u afruar drejt tij, kur para meje po qëndronte një deve e madhe, më të madhe se ajo s'kisha parë më parë, dhe u mundua të më kafshojë. Kjo deve qëndronte mes meje dhe atij. Unë u frikësova shumë, fillova të dridhem dhe u ktheva prapa i frikësuar.

Allahu i Madhëruar e mbrojti pejgamberin e tij Muhamedin a.s.

Ebu Xhehli e kishte gurin në dorë dhe ishte pranë Pejgamberit dhe ai nuk mundi të lëvizë.

Kjo ishte një mrekulli që ai e pa me sytë e tij.

Kurthi i Ebu Xhehlit

Një ditë Ebu Xhehli i përgatiti një kurth Pergamberit a.s.
Hapi një gropë përpara shtëpisë së vet dhe
e thirri Pejgamberin për vizitë në shtëpinë e tij.
Kur Pejgamberi a.s. po shkonte drejt shtëpisë së Ebu Xhehlit vjen Xhibrili a.s. dhe i
tregon për gropën.
Kur e mori vesh këtë gjë, Pejgamberi u kthye në shtëpinë e tij.
Ebu Xhehli kur e pa se ai po kthehej mbrapsht,
u nis t'i shkonte nga pas për ta pyetur për arsyen, por e harroi gropën që kishte hapur
dhe ra në gropën që hapi vetë.
Për ta nxjerr prej aty i zgjatën një litar, por nuk e arrinte dot litarin.
Sa më shumë që i zgjatnin litarin, aq më tepër thellohej gropa.
Në këtë gjendje, Ebu Xhehli gati sa nuk po çmendej brenda gropës së errët.
I dërgon fjalë Pejgamberit a.s. dhe i lutet që ta nxjerr nga gropa.
Kur vjen Pejgamberi pranë tij i thotë:
- Po të nxora nga gropa a do të besosh?
- Po më nxore nga gropa do të besoj - u shpreh Ebu Xhehli.
Pejgamberi a.s. i zgjati dorën e tij dhe e nxori që aty.
Kur doli, Ebu Xhehli tha: - Ne jetën time nuk kam parë kurrë magjistar më të fuqishëm
se ti!
Dhe kështu, vazhdoi të mos besojë, deri sa edhe vdiq si i poshtëruar.

Muhamedit a.s. i kishte zbritur shpallja.
 Tri vite kishte thirrur fshehurazi në Islam.
 Pas tri viteve fillon të thërras haptazi në Islam.
 Shkon në kodrën Safa të Mekës dhe i thërret banorët e Mekës me fise një nga një:
 - O pasardhësit e Fihrit!
 O pasardhësit e Adit!
 O kurejshitë!, dhe kështu me radhë.
 Mekasët u tubuan.
 Shkojnë kurejshët.
 Shkon edhe Ebu Lehebi.

Muhamedi a.s tha: - Çfarë mendoni, po t'ju thosha se në luginë gjendet kalorësia e cila do t'ju sulmojë, a do të më kishit besuar?
 Ata u përgjigjën: - Ne do të besonim, se ti kurrë nuk na ke gënjyer.

Muhamedi a.s. u thotë:
 - Dijeni se unë jam i dërguar te ju që t'ju tërheq vërejtjen për vuajtjet e rënda dhe ndëshkimin që ju pret.

Ebu Lehebi tha:
 - Të shkoftë huq pjesa e mbetur e ditës! A për këtë na ke ftuar?

Allahu i Lartësuar atëherë shpalli:
 - **Le të shkatërrohet Ebu Lehebi.**

Abdullah Ibn Seluli ka qenë koka e Hipokritëve.
Ai ndryshe fliste, ndërsa ndryshe vepronte.

Abdullah Ibn Seluli kur e sheh Ebu Bekrin dhe Umer Ibnul Hatabin u thotë vëllezërve të vet hipokrit:

- Shikoni si janë bërë bashkë këta mendjelehtë.
Kurse kur takohet me ta i pret ndryshe.

Shkon te Ebu Bekri dhe i thotë:

- Mirë se erdhe zotëria i Temimit!

Mirë se erdhe o sidikë!

Mirë se erdhe o shejh i islamit!

Mirë se erdhe shoku i Muhamedit në shpellë!

Mirë se erdhe o ti i cili e ke shpenzuar veten dhe pasurinë për Muhamedin!

Pastaj Ibnu Seluli shkon te Umeri dhe i thotë:

- Mirë se erdhe o zotëria i beni Adijut!

Mirë se erdhe o Faruk!

Mirë se erdhe, o ti i cili e ke shpenzuar pasurinë dhe veten për të dërguarin e Allahut!

Pastaj shkon të Aliu dhe i thotë:

Mirë se erdhe o dhëndër i të dërguarit të Allahut!

Mirë se erdhe o zotëria i beni hashimitëve pas të dërguarit të Allahut!

Abdullah ibn Seluli kur përballëj drejtpërdrejt me Ebu Bekrin, Umerin dhe Aliun fliste fjalë më të mira, ndërsa kur rrinte me vëllezërit e tij hipokritë, i konsideronte mendjelehtë.

JASIRI R.A.	7
SINQERITETI I EBU BEKRIT R.A.	8
VIRTYTET E EBU BEKRI R.A.	9
EBU BEKRI IMAM	10
SI E PRANOI UMERI R.A. ISLAMIN	11
UMERI DHE VAJZA E CILA SHISTE QUMËSHT	12
DREJTËSIA E UMERIT.....	13
UMERI R.A. MERITON RESPEKT.....	14
UMERI R.A. DHE FAMILJA E JETIMIT.....	15
UTHMANI R.A. DHE VAKËFI.....	16
UTHMANI DHE SADAKAJA	17
PRONARI I DY DRITAVE	18
ALIU R.A.....	19
GATISHMËRIA PËR SAKRIFICË	20
USHQIMI HALLALL	21
BILALI R.A.	22
PEJGAMBERËT NUK PRANOJNË SADAKA	23
VULA E PEJGAMBERISË SË MUHAMEDIT A.S.	24
SUHEJBI R.A.	25
VEREKA IBNU NEUFEL	26
EBU DAHDAH R.A.	27
EBU HUREJRE R.A.....	28
ABDURRAHMAN BIN AUFİ R.A.	29
VËLLAZËRIMI I SEAD BIN REBIUT DHE ABDURRAHMAN BIN AUFIT R.A. VETËM PËR ALLAHUN	30
SHTËPIA E EBU EJUBIT R.A.	31
SAD IBNU EBI VEKKASI	32
EBU TALHA DHE GRUAJA E TIJ UMI SELIJM	33
EBU XHEHLI.....	34
KURTHI I EBU XHEHLIT	35
EBU LEHEBI	36
ABDULLAH IBN SELULI	37